

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE
TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS “EDUKIM FIZIK SPORTE
DHE SHËNDET”**



Program orientues

**Koordinator:
Marina Topulli**

2025-2026

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar.....	6
Modele të testeve për secilin nivel arsimor AML dhe për AMU	14
Model pyetjesh të lëndës Edukimit Fizik, Sporte dhe Shëndet, AMU	20
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	26
Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML	27
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore.....	35
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	42
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	44
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	60


HYRJE

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësues, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit punojnë me përgjegjshmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtjesorë, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, zhvillojnë dhe përditësojnë njohuritë nëpërmjet vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve të vazhdueshme, ndërtojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre. Mësuesit që janë të aftë të identifikojnë vështirësitë individuale dhe t'u japin mbështetje të personalizuar nxënësve, ndikojnë ndjeshëm në arritjet e tyre akademike.

Roli i mësuesit në edukimin fizik është shumë i rëndësishëm. Ai jo vetëm që ndihmon në zhvillimin fizik të nxënësve, por gjithashtu kontribuon në formimin e karakterit dhe të sjelljes së tyre. Mësuesi motivon nxënësit të angazhohen në aktivitete fizike dhe t'i kuptojnë përfitimet e një stili jetese aktive. Ai u mëson nxënësve aftësi të ndryshme sportive dhe teknika të lëvizjes, duke përfshirë disiplinat si atletika, futboll, basketbolli, volejboli, hendbolli, gjimnastika, lojëra lëvizore etj. Mësuesi inkurajon zakonet e shëndetshme dhe informon nxënësit mbi rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm dhe aktivitetit fizik për mirëqenien e tyre. Edukimi fizik ndihmon në zhvillimin e vlerave si disiplinë, përkushtim dhe respekt për të tjerët. Mësuesi vlerëson përparimin dhe performancën e nxënësve, duke ofruar feedback dhe mbështetje për përmirësim. Ai siguron që aktivitetet fizike të kryhen në mënyrë të sigurtë, duke minimizuar rrezikun e lëndimeve. Mësuesi mund të përdor teknologjinë për të pasuruar mësimin, duke përfshirë aplikacione dhe mjete që ndihmojnë në ndjekjen e performancës. Mësuesit shpesh janë shembuj për nxënësit, duke ndikuar jo vetëm në njohuritë mësimore, por edhe në vlerat dhe sjelljet që ata përvetësojnë.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;

- 
- për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
 - për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së Edukimit Fizik, Sporte dhe Shëndet është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së Edukimit Fizik, Sporte dhe Shëndet për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë rrisitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike,



antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve të pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për lëndën e Edukimit fizik, Sporte dhe Shëndet në secilin nivel arsimor : *arsim i mesëm i ulët (AMU)* dhe *arsim i mesëm i lartë (AML)*.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizmin e orës së hapur mësimore, tre modele orësh mësimore për lëndën e Edukimit fizik, Sporte dhe Shëndet në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, katër modele projektsh kurrikulare për lëndën e Edukimit fizik, Sporte dhe Shëndet në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- programet lëndore të Edukimit Fizik , Sporte dhe Shëndet;

- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënies – nxënie të lëndës së Edukimit Fizik , Sporte dhe Shëndet;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të Edukimit Fizik , Sporte dhe Shëndet.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË EDUKIMIT FIZIK SPORTE DHE SHËNDET”	
Kompetenca	
“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të edukimit fizik në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme • Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet: • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;	• Korniza Kurrikulare. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX. • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X - XII.

- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;
- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;
- harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit;
- kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit;
- tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të edukimit fizik);
- përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;
- siguron informacion që demonstroi lidhjen e edukimit fizik me shkencat e tjera dhe me jetën reale.

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”

Kompetenca I

“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e edukimit fizik”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.

• Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet: • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevojë të veçantë; • identifikon nxënësit me nevojë të veçantë (nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nxënësit e talentuar); • edukon të nxënësit dëshirën për t'u marrë me sport dhe aktivitete të ndryshme sportive; • motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet në arsimin e mesëm të ulët. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet në arsimin e mesëm të lartë. • Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij
--	---

Kompetenca II

“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e edukimit fizik, sporte dhe shëndet”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:

- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së Edukim fizik Sporte

• përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar; • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të nxënësve përmes krijimit të një situatë të nxënësve; • përdor metoda e teknika që nxënësit dëshirojnë të nxënësit për t'u marrë me sport; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në hapat e metodologjisë së lojës (volejbolli, basketbolli, futboll, hendbolli etj.); • përdor metoda e teknika që nxënësit zhvillojnë fizikisht të nxënësit; • përdor metoda e teknika që sigurojnë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në orën e edukimit fizik; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një detyre përmblendhëse.	dhe Shëndet në arsimin e mesëm të ulët. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së Edukimit fizik Sporte dhe Shëndet në arsimin e mesëm të lartë. • Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP Lënda: Edukimi Fizik, Sporte dhe Shëndet.
--	--

Kompetenca III

“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në edukimit fizik”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:

- prezanton materiale mësimore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Math Type në Word;

- Literaturë që ka në fokus përdorimin e programeve kompjuterike që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus

• nxënës të bëjnë prezantime të materialeve mësimore duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënien nxënien; • përfshin nxënës në projekte kurrikulare të lëndës së Edukim fizik sporte dhe shëndet apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website.	përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie –nxënie • Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” • Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP .
--	--

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> • njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. • Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - njih rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; - demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së Edukimit Fizik, Sporte dhe Shëndet”	
<i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e Edukimit fizik sporte dhe shëndet në klasat VI-IX dhe X-XII; - shpjegon vlerat fizike konjiktive dhe afektive të veprimtarisë lëvizore dhe sportive; - përshkruan parimet shkencore të të ushtruarit me aktivitet lëvizor dhe sportiv;	- Programe dhe materiale ndihmëse për lëndën e Edukimit fizik sporte dhe shëndet për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë. - Librat: Metodika e edukimit fizik, - Didaktika e edukimit fizik; Edukim lëvizor; Lojërat lëvizore

• argumenton kuptimin dhe shëndetin fizik e funksional (funksionet e aparatit respirator dhe kardiovaskular); • shpjegon me saktësi zhvillimin e fleksibilitetit, aftësive motore, zhvillimin e aftësive koordinative; • përshkruan zhvillimin dhe ndryshimet fizike e trupore të nxënësve, nga njëri vit në tjetrin; • përshkruan teknikat dhe rregullat e organizimit të lojërave sportive (volejball, basketboll, futboll, hendboll) dhe sporteve individuale (atletikë, gjimnastikë, tenis etj) • shpjegon mirë faktorët e zhvillimit të përgatitjes së përgjithshme fizike (atletikë, gjimnastikë, fitnes).	dhe edukimi(2004); Anatomi, Fiziologji ushtrimi; Volejball; Basketboll; Gjimnastike; Atletikë; Futboll, Hendboll. • Programet për klasat sportive. • Programet për nxënësit me aftësi ndryshe(AK)
--	---

Modele të testeve për secilin nivel arsimor AML dhe për AMU

Model pyetjesh të lëndës Edukimit Fizik, Sporte dhe Shëndet, AML

A. PROGRAMI LËNDOR

Pyetja 1

Edukimi lëvizor është proces:

- A) Filozofik
- B) Sportiv
- C) Sociologjik
- D) Pedagogjik

Pyetja 2

Qarkoni përgjigjen e saktë.

Bazuar në kurrikulën me kompetenca, *situata e të nxënit* që planifikohet në planin ditor të mësuesit:

- A) është e detyruar të planifikohet në çdo orë mësimi;
- B) është pjesë e rezultateve të të nxënit të orës së mësimi;
- C) planifikohet vetëm në planin tremujor të periudhës;
- D) lidhet me metodologjinë dhe me organizimin e orës së mësimi.

B. ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

Pyetja 3

Kusht i domosdoshëm për edukimin e veprimeve lëvizore është :

- A) Mjedisi sportiv
- B) Kapaciteti fizik i nxënësve
- C) Treguesit antropometrik
- D) Njohuritë e nxënësve

Pyetja 4

“Metodika e procesit mësimor” në lëndën Edukimit fizik ka të bëjë me:

- A) Përfshirjen e metodave të mësimdhënies.
- B) Format dhe mënyrat e zhvillimit të mësimimit.
- C) Përdorimi i mjeteve dhe veglave didaktike.
- D) Të gjitha.

Pyetja 5

Cila nga format është më kryesore në zhvillimin fizik të fëmijëve nga 10-14 vjeç?

- A) Forma e garës
- B) Forma e lojës
- C) Forma e garë-lojë
- D) Forma lojë-garë

Pyetja 6

Cilat nga këta elemente kanë më tepër rëndësi teknike në ekzekutimin e pasimit të lëvizjeve në lojën e basketbollit?

- A) Shtrirja e krahëve.
- B) Shtytja e topit me kyçet e duarve dhe kapja me mollëzat e gishtave.
- C) Shtytja e topit me forcë e shpejtësi, por të jetë i kapshëm nga partneri
- D) Apo të gjitha.

Pyetja 7

Cili nga alternativat tregon rrugën metodike të ushtrimit praktik, nëpërmjet të cilës arrihet përmirësimi i teknikës individuale të nxënësit në disiplinat e lojërave sportive?

- A) Nëpërmjet ushtrimeve analitike, përsëritja e ushtrimeve stereotipe.
- B) Nëpërmjet ushtrimeve që e vendosin lojtarin në situatë agonistike.
- C) Nëpërmjet lëvizjeve të koordinuara, të rrjedhshme dhe të sakta.
- D) Apo të gjitha.

Pyetja 8

Cilat janë fazat kryesore të teknikës individuale të gjuajtjes në lojërat me dorë?

- A) Vrulli – Rënia – Gjuajtja
- B) Vrulli – Rrahja – Ngritja – Gjuajtja – Rënia
- C) Ngritja- Shtrirja e krahut – Rënia – Gjuajtja
- D) Rrahja – Vrulli – Rënia – Goditja

C. ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

Pyetja 9

Mësuesi ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën?

- A) Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- B) Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- C) Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.
- D) Mësuesja e inkurajon dhe i kërkon Jonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.

Pyetja 10

Për fëmijët me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, mësuesi ndihmës bën vlerësimin sipas niveleve të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI. Ky vlerësim duhet bërë në bashkëpunim:

- A) me drejtuesin e institucionit arsimor dhe specialistë të patologjisë/ve që shfaq fëmija.
- B) me mësuesin e lëndës dhe shërbimin psiko-social të institucionit arsimor.
- C) me prindin dhe kujdestarët që kujdesen për fëmijën.
- D) me komisionin multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.

D. ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) klasat 9-ta të shkollës
- B) klasat e 9 të shkollës
- C) klasat e 9-ta të shkollës
- D) klasat e 9-të të shkollës

Pyetja 12

Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.

- A) Institucion arsimor
- B) Institucionë arsimorë
- C) Institucion arsimor
- D) Institucion arsimor

E. PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Pyetja 13

Përvetësimi dhe zhvillimi i “Shprehive fizike e koordinative” nëpërmjet lojërave lëvizore arrihet:

- A) Në mënyrë të natyrshme
- B) Në formë të drejtpërdrejtë
- C) Në mënyrë të sforcuar
- D) Në kushte të lehtësuara

Pyetja 14

Qarkoni alternativën që shpreh “Veprim ciklik”:

- A) Pasimi i topit
- B) Hedhja nga trampolina

- C) Vrapimi
- D) Shtytja e gjyles

Pyetja 15

Gjatë kryerjes së aktivitetit fizik cili nga "Burimet energjitike" konsumohet i pari:

- A) Yndyrnat
- B) Proteinat
- C) Kripërat minerale
- D) Karbohidratet

Pyetja 16

Në aparatën lëvizore të trupit NUK bën pjesë:

- A) Kockat
- B) Organet
- C) Artikulacionet
- D) Muskujt

Pyetja 17

"Kifoza" është deformim i:

- A) Gjymtyrëve të poshtme
- B) Gjymtyrëve të sipërme
- C) Shtyllës kurrizore
- D) I kafkës

Pyetja 18

Si realizohet kombinimi i veprimeve fizike në aktivitete e lojërave lëvizore

- A) Me e mbi vegla didaktike
- B) Me objekte rrethore
- C) Me objekte të përcaktuara
- D) Me synime e konkrete afatgjatë

Pyetja 19

Gjatë edukimit të “Veprimeve lëvizore” është i domosdoshëm përcaktimi :

- A) Mjedisi sportiv
- B) Kapaciteti fizik i nxënësve
- C) Treguesit antropometrik
- D) Njohuritë e nxënësve

Pyetja 20

Mosha më përshtatshme për zhvillimin e “Aftësive koordinative”:

- A) 2- 4 vjeç
- B) 15-17 vjeç
- C) 22-24 vjeç
- D) 7-11 vjeç

Pyetja 21

Praktikimi i “Aktivitetit fizik” sjell ndryshime të dukshme në:

- A) Rritjen e pagjumësisë.
- B) Zvogëlimin e masës muskulore.
- C) Rritjen e kapacitetit vital të mushkërive.
- D) Zvogëlimin e VO_2 max(fuqia aerobike).

Pyetja 22

Cili nga faktorët NUK ndikon në zhvillimin e aftësisë së fleksibilitetit:

- A) Mosha
- B) Niveli hormonal
- C) Muskujt që e rrethojnë artikulacionin
- D) Temperatura e brendshme e artikulacionit

Model pyetjesh të lëndës Edukimit Fizik, Sporte dhe Shëndet, AMU

A. PROGRAMI LËNDOR

Pyetja 1

Përzgjedhja e mjeteve mësimore nga mësuesi për orën e mësimit është në funksion të:

- A) Planit të aktiviteteve të klasës
- B) Planit ditari të mësuesit
- C) Programit lëndor
- D) Menaxhimit të klasës gjatë mësimit

Pyetja 2

Tematika “Edukim Nëpërmjet Aktiviteteve Fizike” realizohet në:

- A) 20 orë
- B) 30 orë
- C) 40 orë
- D) 45 orë

B. ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

Pyetja 3

Metoda më e përdorur e edukimit lëvizor është:

- A) Metoda e lojës
- B) Metoda konkrete
- C) Metoda parësore
- D) Metoda empirike

Pyetja 4

Metoda që ndjek mësuesi për zhvillimin e një ore mësimi është :

- A) Artistike
- B) Emocionale
- C) Organizative-Metodike
- D) Krijuese

Pyetja 5

Rretho saktë fazat teknike të vrapimeve atletikore.

- A) Starti, vrulli i nisjes, vrapimi në distancë dhe mbërritja.
- B) Reagimi në nisje, koncentrimi, shkëputja, kontrollimi gradual.
- C) Forcat e fërkimit dhe kundërveprimit me rrymat e ajrit, e kombinimit lëvizor dhe e përmbylljes.
- D) Fazat e baraspeshimit, e autokontrollit, e ritmit të vrapimit të lirë.

Pyetja 6

Zgjedhja e mjeteve didaktike për orën e mësimi planifikohet në:

- A) Planin e aktiviteteve të klasës
- B) Planin ditar të mësuesit
- C) Planifikimin tremujor
- D) Planifikimin vjetor

Pyetja 7

Edukimi lëvizor realizohet nëpërmjet:

- A) Metodës së lojës
- B) Metodës konkrete
- C) Metodës parësore
- D) Metodës empirike

Pyetja 8

Pozicioni i mësuesit gjatë rreshtimit të nxënësve është:

- A) Përballë dritës
- B) Nga e majta e dritës
- C) Nga e djathta e dritës
- D) Nga mbrapa dritës

C. ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

Pyetja 9

Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:

- A) vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm;
- B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh;
- C) vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm;
- D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

Pyetja 10

Procesi i gjithëpërfshirjes fillon me:

- A) nxitjen e diferencave mes nxënësve.
- B) njohjen dhe pranimin e diferencave mes nxënësve.
- C) zhvillimin e të drejtave të nxënësve.
- D) thellimin e diferencave mes nxënësve.

D. ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
- B) Proçedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
- C) Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të Ministrit.
- D) Proçedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me Udhëzim të Ministrit

Pyetja 12

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Portofoli profesional i mësuesit
- B) Portofoli profesjonal i mësuesit
- C) Portofoli profesional i mësuesit
- D) Portofoli profesijonal i mësuesit

E. PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Pyetja 13


“Elementi bazë” në lojërat lëvizore është:

- A) Kërcimi
- B) Hedhja
- C) Saktësia
- D) Vrapimi

Pyetja 14

“Vrapimi” është zhvendosja horizontale:

- A) Pa fazë fluturimi
- B) Me fazë fluturimi
- C) Me fazë dy mbështetëse
- D) Apo të gjitha



Pyetja 15

Me termin “Forcë, Shpejtësi, Qëndrueshmëri” kuptojmë

- A) Vetë fizike
- B) Aftësi psiko-motore
- C) Aftësi fizike
- D) Përgatitje fizike

Pyetja 16

Testi që kontrollon “Aftësinë Motorike” është:

- A) Hedhja e pritja e topit
- B) Vrapim 5x10 vajtje-ardhje
- C) Kërcim së gjati nga vendi
- D) Vrapim 30m

Pyetja 17


Veprim aciklik “Nuk” është:

- A) Vrapimi
- B) Kërcimet
- C) Hedhjet
- D) Asnjëra

Pyetja 18

Ndryshimet strukturore trupore arrihen nëpërmjet:

- A) Veprimtarive fizike
- B) Ushtrimeve fizike
- C) Ushtrimeve aerobike
- D) Apo të gjitha



Pyetja 19

Zgjerimi i enëve të gjakut gjatë punës me intensitet të lartë ndodh nga:

- A) Rritja e presionit të gjakut
- B) Stimujve kimike
- C) Lodhja
- D) Djersitja

Pyetja 20

Rrahjet e zemrës në minutë tek njerëzit e pa stërvitur në gjendje qetësie janë:

- A) 30
- B) 40
- C) 70
- D) 100

Pyetja 21

Hormoni i rritjes së trupit prodhohet në:

- A) Tiroide
- B) Epifizë
- C) Hipofizë
- D) Mbi veshkore

Pyetja 22

Komponenti bazë i “Lakueshmërisë Fizike” është :

- A) Elasticiteti
- B) Amplituda
- C) Lëvizshmëria
- D) Të gjitha

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përsa i përket mënyrës sesi ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënës dhe përshtaten me stilet e të nxënës dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirë menduar dhe e mirë planifikuar, si dhe një mjedis të nxënës efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënës që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur tre modele orësh mësimore për lëndën e Edukimit fizik, Sporte dhe Shëndet në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënit, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.


Model ore mësimore në lëndën e Edukim fizik sporte dhe shëndet AML

Fusha: Edukim Fizik Sporte dhe Shëndet	Lënda: Edukim Fizik Sporte dhe Shëndet	Shkalla 5	Klasa 10
Tematika: Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike (stafetë lëvizore)		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: Stafetë lëvizore (me mjete)		Mësimi i rregullave dhe organizimi i stafetës	
		Edukimi i aftësisë së reagimit dhe shkathtësisë së lëvizjes dhe rritjen e aftësisë së kryerjes së teknikës së vrapimit	
Rezultatet e të nxënit për fushë/lëndë që synohen të realizohen.		Fjala Kyçe:	
nxënësi:		Stafetë; Vrapim	
Perfeksionon teknikën e vrapimit të shpejtësisë.		Shpejtësi; koordinim	
Rrit nivelin e shpejtësisë së vrapimit dhe koordinimit të lëvizjeve.		Rregull; Organizim	
Zhvillon gjendjen emocionale gjatë ekzekutimit të stafetës dhe rrit ndjenjën e bashkëpunimit dhe frymën e fitores.		Mjetet: shkop stafete, flamur, top etj.	
Lidhja me lëndët e tjera: Fizika; Qytetaria; Arte		Burimet: Program i lëndës	
		Libër: lojërat lëvizore dhe edukimi (2004)	
MEDODAT E PËRDORURA PËR PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE			

(ME QENDËR MËSUESIN VERBALE –KONKRETE) (ME QËNDER NXËNËSIN KËRKIMORE PROBLEMORE)

PJESËT	<i>Zhvillimi i orës</i>	Koha	Koha totale	Udhëzimet organizativo - metodike
PERGATITORE	Organizimi i klasës për mësim Prezantimi i temës, njohja me situatën e të nxënësve Zhvillimi i nxehtësisë së organizimit me anë të ushtrimeve përgatitore të përgjithshme	2’ 3’ 10’	15’	Rreshtoj klasën Evidentimi i pjesëmarrjes, uniformës, dhe gjendjes shëndetësore Shpjegoj qëllimin dhe objektivat e realizimit të stafetës Kryerja e ushtrimeve të nxehtësisë në funksion të strukturës së stafetës: Vrapim i lehtë Ushtrime të përgjithshme për nxehtësi: nxehtësia e gjymtyrëve të sipërme, trungut dhe të poshtme.
THEMELORE	Njohja me rregullat dhe organizimin e stafetës. Shpjegim, demonstrim i pjesshëm i stafetës (nga mësuesi) Kryerja e stafetës me temp të ngadaltë dhe në mënyrë të pjesshme	5’ 5’ 10’	25’	Grumbulloj nxënësit në qendër të terrenit sportive shpjegoj stafetën me demonstrime. i vendosim nxënësit në 4 skuadra në dy ekipe sipas vendeve përkatëse. Duke e vendosur ekipin përballë njëri-tjetrit. (A₁-A₂; B₁- B₂)

	Kryerja e ndërrimit të mjeteve) shkop; top) Koordinimi më shokun e skuadrës Kryerja e skemës së plotë të stafetës sipas rregullave dhe rritja e shkallës së vështirësisë. Përsëritja e stafetës	5'	Me rënien e sinjalit niset me vrapim A₁ dhe B₁ në drejtim të gjysmës tjetër të skuadrës përballë A₂ dhe B₂ dhe u dorëzojnë shkopinjtë e stafetës. Menjëherë pas këtij veprimi nxënësit vazhdojnë vrapimin dhe vendosen në fund të rreshtit. Veprimet përsëriten derisa nxënësi i fundit mbaron ndërrimin dhe ngre dorën për përfundimin e saj. Stafeta përsëritet disa herë duke evidentuar skuadrën më të shpejtë.
MBYLLJA	Organizmi i ushtrimeve të qetësisimit rregullimi i frymëmarrjes dhe streçing pasiv. Konkluzionet rreth orës dhe efektivitetit të saj. Shoqërimi i klasës.	5'	Ecje rreth fushës për kthimin e organizmit në gjendjen fillestare Ushtrime pasive streçingu për të gjithë trupin. Diskutim dhe analizë e orës dhe nxjerrje e konkluzioneve dhe detyrave për orën e ardhshme.
Vlerësimi: Gjatë orës përdoren fjalë inkurajuese duke i vënë në dukje elementët më pozitive të shfaqura nga nxënësit. Niveli- 2 – Demonstron pjesërisht elementët teknik të vrapimit, reagimit dhe koordinimit lëvizor.			



Niveli- 3 – Kryen kombinime të elementëve teknik në përmbajtje të stafetës.


Niveli -4 – Ekzekuton saktë teknikën e elementëve dhe shfaq aftësi të larta lëvizore për arritjen e rezultatit të dëshiruar.

Model ore mësimore në lëndën e Edukim fizik sporte dhe shëndet AMU

Fusha: Edukim Fizik Sporte dhe Shëndet		Lënda: Edukim Fizik Sporte dhe Shëndet		Shkalla 4	Klasa 9
Tematika: Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike (stafetë lëvizore)				Situata e të nxënës:	
Tema mësimore: Stafetë lëvizore “Drejtvizore e dyfishtë”				Mësimi i rregullave dhe organizimi i stafetës	
				Edukimi i aftësisë së reagimit dhe shkathtësisë së lëvizjes dhe rritjen e aftësisë së kryerjes së teknikës së vrapimit	
Rezultatet e të nxënës për fushë/lëndë që synohen të realizohen.				Fjala Kyçe:	
nxënësi: - Perfeksionon teknikën e vrapimit të shpejtësisë. - Rrit nivelin e shpejtësisë së vrapimit dhe koordinimit të lëvizjeve. - Zhvillon gjendjen emocionale gjatë ekzekutimit të stafetës dhe rrit ndjenjën e bashkëpunimit dhe frymën e fitores.				Stafetë; Vrapim	
				Shpejtësi; koordinim	
				Rregull; Organizim	
				Mjetet:	
				shkop stafete , flamur, top etj.	
Lidhja me lëndët e tjera: Fizika; Qytetaria ;Arte				Burimet: Program i lëndës	
				Libër: lojërat lëvizore dhe edukimi (2004)	
MEDODAT E PËRDORURA PËR PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE					
(ME QENDËR MËSUESIN VERBALE –KONKRETE) (ME QËNDER NXËNËSIN KËRKIMORE PROBLEMORE)					
PJESËT	Zhvillimi i orës	Koha e usht	Koha totale	Udhëzimet metodike	organizativo -

PERGATITORE	Organizimi i klasës për mësim	2'	15'	Rreshtoj klasën
	Prezantimi i temës, njohja me situatën e të nxënit	3'		Evidentimi i pjesëmarrjes, uniformës, dhe gjendjes shëndetësore
	Zhvillimi i nxehjes së organizmit me anë të ushtrimeve përgatitore të përgjithshme	10'		Shpjegoj qëllimin dhe objektivat e realizimit të stafetës Kryerja e ushtrimeve të nxehjes në funksion të strukturës së stafetës: Vrapim i lehtë Ushtrime të përgjithshme për nxehje: nxehja e gjymtyrëve të sipërme, trungut dhe të poshtme.

THEMELORE	Njohja me rregullat dhe organizimin e stafetës. Shpjegim, demonstrim i pjesshëm i stafetës (nga mësuesi)	5'	25'	Grumbulloj nxënësit në qendër të terrenit sportive shpjegoj stafetën me demonstrime.
	Njohja dhe demonstrim i pjesshëm i stafetës (nga mësuesi)	5'		I vendosim nxënësit në 4 skuadra në dy ekipe sipas vendeve përkatëse. Duke e vendosur ekipin përballë njërit-tjetrit. (A ₁ -A ₂ ; B ₁ - B ₂)
	Kryerja e stafetës me temp të ngadaltë dhe në mënyrë të pjesshme	10'		Me rënien e sinjalit niset me vrapim A ₁ dhe B ₁ në drejtim të gjysmës tjetër të skuadrës përballë A ₂ dhe B ₂ dhe u dorëzojnë shkopinjtë e stafetës.
	Kryerja e ndërrimit të mjeteve (shkop; top)			Menjëherë pas këtij veprimi nxënësit vazhdojnë vrapimin dhe vendosen në fund të rreshtit.
	Koordinimi më shokun e skuadrës			Veprimet përsëriten derisa nxënësi i fundit mbaron ndërrimin dhe ngre dorën për përfundimin e saj.
	Kryerja e skemës së plotë të stafetës sipas rregullave dhe rritja e shkallës së vështirësisë.	5'		Stafeta përsëritet disa herë duke evidentuar skuadrën më të shpejtë.
MBYLLJA	Përsëritja e stafetës			
	Organizmi i ushtrimeve të qetësimit rregullimi i frymëmarrjes dhe steçing pasiv.	5'	5'	Ecje rreth fushës për kthimin e organizmit në gjendjen fillestare
	Konkluzionet rreth orës dhe efektivitetit të saj.			Ushtrime pasive streçingu për të gjithë trupin.
	Shoqërimi i klasës.			Diskutim dhe analizë e orës dhe nxjerrje e konkluzioneve dhe detyrave për orën e ardhshme.



Vlerësimi : Gjatë orës përdoren fjalë inkurajuese duke i vënë në dukje elementët më pozitive të shfaqura nga nxënësit.

Niveli- 2 – Demonstron pjesërisht elementët teknik të vrapimit, reagimit dhe koordinimit lëvizor.

Niveli- 3 – Kryen kombinime të elementëve teknik në përmbajtje të stafetës.

Niveli- 4 – Ekzekuton saktë teknikën e elementëve të stafetës dhe shfaq aftësi të larta lëvizore për arritjen e rezultatit të dëshiruar.

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore:

- mbështesin mësuesit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore për të gjykuar dhe për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
	0 pikë	1 pikë	2 pikë	3 pikë
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësve.	Nuk ka një koherencë mes komponentëve të orës mësimore. Rezultatet e të nxënësve (RN) nuk bazohen në programin lëndor. Metodologjia është	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësve, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënësve (RN) ose	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësve, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësve, cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e

	tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënësve. Pyetjet që janë planifikuar nuk janë të llojeve dhe të niveleve të ndryshme.	nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënësve. Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.	teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënësve dhe me stilet e të nxënësve. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënësve, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore.	Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.	Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.	Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke	Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe

			<i>lënë mënjane kompetencat kyç të të nxënës gjatë gjithë jetës.</i>	<i>rezultate të kompetencave kyç të të nxënës gjatë gjithë jetës.</i>
Mjedisi i të nxënës (6 pikë)				
Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënës të trajtohen në mënyrë barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, por jo të gjithë nxënës kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës përfshihen në veprimtaritë e orës së mësimit për të shprehur mendimet e tyre.</i>	<i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënës nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi kujdeset që nxënës të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënës duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënës duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen.</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo të gjithë nxënës përfshihen dhe</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënës të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënës të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të</i>

iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve marrin një lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve marrin një përgjigje.</i>	<i>detyra motivuese duke i lënë disi pasivë. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve marrin një përgjigje.</i>	<i>ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
--	--	---	--	---

Metodat mësimore (6 pikë)

Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi, duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxitin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, por vetëm disa</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumë llojshmëri të metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, që nxisin</i>
---	--	--	---	--

	zhvillimit të orës mësimore, mësimi përqendrohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.	mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.	nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.	diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi.	Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe llojeve të niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit	Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi por nuk u jep mundësi të përgjigjen vetë.	Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi, por nuk u jep mundësi të përgjigjen vetë.	Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi.

	<i>nxënësit të bëjnë pyetje..</i>			
Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)				
Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit. Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi e përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit, duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga</i>

			<i>mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të nxënësve.	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësve apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara, duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjetet mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetëm mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetëm mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nuk i angazhon shumë nxënës në përdorimin e tyre.</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjetet mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxënësit të ata të tyre.</i>

				<i>mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore,</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale, por ato nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular

Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- *Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.*
- *Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat.*

- *Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.*
- *Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënësve që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.*
- *Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.*

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model 1 i një projekti kurrikular për nxënësit

Tema e projektit: "Sporti dhe mirëqenia fizike në popullatë"

Kohëzgjatja: 6 orë, (të planifikuara 6 orë për çdo periudhë mësimore).

Klasa: 7-të ose e 8-të

Rezultatet e të nxënës: Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi aplikon njohuritë organizative për inkurajimin e pjesëmarrjeve në aktivitete të cilat nxisin veprimtaritë sportive për përfitime që sjell aktiviteti fizik si model ose stil jetese aktive. Krijimi i materialeve edukative për komunitetin.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- intervista, anketa, kampionimi;
- grumbullimi i të dhënave;
- përpunimi i të dhënave;
- tabelat, diagramet,
- paraqitja grafike e të dhënave;
- interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

Partnerët: target e individëve që do të anketohen.

Burimet kryesore të informacionit: anketa, intervista, pyetësorë, materiale nga interneti


Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

- Përzgjedhja e temës, diskutimi
- Hulumtimi mbi temën
- Mbledhja e të dhënave
- Analiza e të dhënave
- Prezantimi i të dhënave
- Diskutim dhe Reflektim

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

Diskutoni me nxënësit rëndësinë e aktivitetit fizik në ndihmë të uljes së rrezikut të sëmundjeve kronike si obeziteti, diabeti tip 2, sëmundjet kardiovaskulare, forcimi i sistemit imunitar. Organizimi i aktiviteteve sportive që përfshijnë të gjitha grupet e moshave dhe nivelet e aftësive, duke promovuar një kulturë të shëndetshme dhe ulje të nivelit të sedentarizmit. Sporti nxit bashkëpunimin dhe komunikimin mes individëve, duke forcuar marrëdhëniet ndër personale.

- Kërkojuni nxënësve të identifikojnë dhe të mbledhin situata nga jeta reale mbi nivelin e kryerjes së aktivitetit fizik në popullatë. Këto mund të përfshijnë situata në shtëpi, në shkollë, gjatë aktiviteteve të kohës së lirë ose në komunitet.
- Nxënësit hulumtojnë dhe dokumentojnë këto situata, duke shpjeguar ose evidentuar nivelin e kryerjes së aktivitetit fizik sipas grup moshave gjithashtu edhe nivelin e sedentarizmit.
- Caktoni nxënësve koncepte specifike të sportit, aktivitetit fizik, ushtrimit fizik, plotë shëndetshmërisë, obezitetit, zonës së riskut nga sëmundjet si rrjedhojë e mos lëvizjes, sedentarizmit.
- Nxënësit hetojnë se si këto koncepte perceptohen në popullatë duke hulumtuar shembuj, duke kryer intervista, anketa ose histori reale.
- Inkurajoni nxënësit të krijojnë paraqitje vizuale për të demonstruar gjetjet e tyre, duke përfshirë shpjegimet e koncepteve të sportit, aktivitetit fizik, plotë shëndetshmërisë dhe qasjet që shfaqen në komunitet.
- Udhëzoni nxënësit në organizimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura duke përdorur mjete të analizës statistikore.
- Nxënësit nxënësit të reflektojnë mbi kërkimet dhe përvojat e tyre gjatë gjithë projektit. Ata analizojnë rëndësinë e sportit dhe aktivitetit fizik ku pjesëmarrja e rregullt ka sjell përfitime të rëndësishme në krijim e një stili jetese të shëndetshme.
- Nxënësit përgatisin një prezantim përfundimtar për të ndarë gjetjet e projektit të tyre me klasën ose një audiencë më të gjerë, si prindërit ose nivelet e tjera të klasave.
- Lehtësoni diskutimet në klasë ku nxënësit mund të ndajnë gjetjet e tyre, të përfshihen në analiza kritike dhe të vlerësojnë efektivitetin e qasjeve të ndryshme për ndikimin e sportit dhe aktivitetit fizik në plotë shëndetshmërinë e komunitetit dhe forcimit të marrëdhënieve ndër personale.

- 
- Nxitini nxënësit të reflektojnë mbi të nxënit e tyre, të marrin në konsideratë perspektiva alternative dhe të propozojnë strategji ose veprime shtesë.

Përshkrimi i produktit të projektit: Inkurajoni nxënësit të organizojnë një ekspozitë ose vitrina ku nxënësit të prezantojnë projektet e tyre para komunitetit të shkollës, duke ftuar prindërit, mësuesit dhe shokët e tyre të marrin pjesë. Inkurajoni nxënësit të përfshihen në diskutime dhe t'u përgjigjen pyetjeve rreth projekteve të tyre, duke nxitur efektivitetin e qasjeve të ndryshme për ndikimin e sportit dhe aktivitetit fizik në plotë shëndetshmërinë e komunitetit dhe forcimit të marrëdhënieve ndër personale.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer mbi Sportin dhe mirëqenien fizike në popullatë.
- ***Niveli i analizës së situatës:*** Qartësia e paraqitjes së informacionit për të vlerësuar përfitimet, pjesëmarrjen, dhe rezultate të tjera të matshme.
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e reflektimit mbi rëndësinë dhe sfidat e hasura gjatë projektit.

Model 2 i një projekti kurrikular për nxënësit në AMU

Tema e projektit: HISTORIKU I BASKETBOLLIT SHQIPTAR

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: Projekti do të zgjasë gjatë tre periudhave të realizuara në 6 orë mësimore në lëndën e edukimit fizik, sporte dhe shëndet , të planifikuara 2 orë për çdo periudhë.

Klasa/t pjesëmarrëse: Klasa IX

Rezultatet e të nxënësve – Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi të dallojnë informacionin e marrë nga interneti , nga literatura e rrjete sociale. Të rendisin logjikisht sipas çështjeve të dhëna materialet e gjetura. Të arrijnë të realizojnë e strukturojnë materialet në format digjitale. Realizojnë postera ose fletëpalosje me një mesazh të caktuar. Të zhvillojnë prezantime në publik dhe të argumentojnë gjetjet.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- pyetësi, intervista, popullata,
- grumbullimi i të dhënave;
- përpunimi i të dhënave;
- tabelat, diagramet,
- paraqitja vizuale e të dhënave;
- interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

Partnerët që do marrin pjesë në projekt – prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

Burimet kryesore të informacionit:

- Kërkime në internet .
- Revista e gazeta të ndryshme, libra etj.
- Biseda me prindër, mësues.
- Konsulta me specialistë të sportit
- Etj.

Tematika e orëve të planifikuara:

- *Ora 1.* Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- *Ora 2.* Paraqitja e materialeve të grumbulluara nga grupet e punës. Diskutimi i planit të veprimtarive
- *Ora 3.* Diskutime e debate mbi materialet e grumbulluara në lidhje me temën.
- *Ora 4.* Analiza e materialeve të projektit e përpunimi i tyre. Jepen këshilla apo sugjerime për përmirësimin e punës në rast se është e nevojshme
- *Ora 5.* Seleksionimi i materialeve që do të jenë më të qarta për zbatimin e këtij projekti. Hartimi i draftit përfundimtar të projektit dhe diskutimi i tij.
- *Ora 6.* Prezantimi përfundimtar i projektit , vlerësimi i tij dhe konkluzionet për secilin nxënës ose grup

Veprimtaritë kryesore:

- Diskutime mes mësuesit dhe nxënësve për burimet e informacionit. Nxënësit ndahen në grupe sipas aftësive dhe dëshirës. Pas zgjedhjes së liderit të grupit ndahen detyrat për çdo anëtar. Shpjegimi nga mësuesi mbi qëllimin dhe rëndësinë e projektit. Caktimi i detyrave të orës së ardhshme. Mësuesi në bashkëpunim me liderët e grupeve caktojnë afatet e kryerjes së detyrave.
- Paraqitja e materialeve të grumbulluara nga grupet e punës. Nxënësit punojnë në grupet e tyre. Nëpërmjet teknikës “Rrjeti i diskutimit”, nxënësit diskutojnë situatat dhe të dhënat e siguruar nga burime të ndryshme. Nëpërmjet metodës “Mbajtja e strukturuar e shënimeve”, lideri i grupit mban shënime për të gjitha diskutimet dhe zgjidhjet e mundshme të situatave përkatëse. Më pas bën një përmbledhje të tyre i ndihmuar dhe nga shokët e grupit. Nxënësit përzgjedhin materialet që do të përdorin për projektin. Dhënia e mendimit të mësuesit rreth çështjeve të diskutuara për të orientuar nxënësit pasi të jenë dhënë mendimet e tyre .
- Diskutime e debate mbi materialet e grumbulluara në lidhje me temën. Nxënësit paraqesin punën sipas grupeve të tyre. Nxënësit i përgjigjen pyetjeve të shokëve nga grupet e tjerë dhe komenteve të mësuesit. Grupet respektojnë kohën e përcaktuar për argumentim.

- Analiza e materialeve të projektit, përpunimi i materialeve të projektit. Nxënësit rendisin materialet sipas nën çështjeve të planifikuara.
- Seleksionimi i materialeve që do të jenë më të qarta për zbatimin e këtij projekti. Nxënësit rendisin materialet sipas nën çështjeve të planifikuara. Përmes diskutimeve me njëri-tjetrin në seleksionimin e materialeve, nëpërmjet punës në grup arrijnë të realizojnë detyrat dhe në shkëmbimin e eksperiencave.
- Prezantimi përfundimtar i projektit , vlerësimi i tij dhe konkluzionet për secilin nxënës ose grup. Prezantimi përfundimtar i projektit nga secili nxënës apo grup pune duke e paraqitur në format A4 , prezantim në PowerPoint , ose në postera.
- Vlerësimi i projektit ,konkluzionet për secilin grup. Bashkëbisedim , vëzhgim i detajuar, diskutim ,sintetizim.
- Lehtësoni diskutimet në klasë ku nxënësit mund të ndajnë gjetjet e tyre, të përfshihen në analiza kritike dhe të vlerësojnë efektivitetin e qasjeve të ndryshme rreth historisë së sportit në Shqipëri.
- Nxitini nxënësit të reflektojnë mbi të nxëniet e tyre, të marrin në konsideratë perspektiva alternative dhe të propozojnë strategji ose veprime shtesë.

Përshkrimi i produktit të projektit

Projekti mund të paraqitet me mënyra të ndryshme: mund të organizohen në një poster; mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik power point, nëse është produkt prezantohet produkti etj.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer historinë e sportit të basketbollit në Shqipëri.
- ***Niveli i analizës së situatës:*** Qartësia e paraqitjes së informacionit për të vlerësuar përfitimet, pjesëmarrjen, dhe rezultate të tjera të matshme.
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e reflektimit mbi rëndësinë dhe sfidat e hasura gjatë projektit.

Model 3 i një projekti kurrikular për nxënësit në AML

Tema e projektit: " Sporti dhe roli i tij në rritjen e performancës shkollore"

Kohëzgjatja: 6 orë, (të planifikuara 2 orë për çdo periudhë mësimore).

Klasa: X ose XI

- ***Rezultatet e të nxënit:*** Identifikimi i rolit të aktivitetit fizik dhe disiplinave sportive në ndikimin e përmirësimit të rezultateve shkollore dhe socializmin në shkolle. Perceptimi i koncepteve bazë mbi temën. Kërkimi i informacionit rreth ndikimit të aktivitetit fizik e sportit në ndryshimet e sistemeve të njeriut. Pjesëmarrja në realizimin e këtij projekti, përmes punës në grup do të rrisë besimin e nxënësve në aftësitë e veta dhe dëshirën për të bashkëpunuar.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- pyetësi, intervista, anketa, kampionimi;
- grumbullimi i të dhënave;
- përpunimi i të dhënave;
- tabelat, diagramet,
- interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

Partnerët: target e individëve që do të anketohen.

Burimet kryesore të informacionit: anketa, intervista, pyetësorë, materiale nga interneti

Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

- Përzgjedhja e temës, diskutimi
- Hulumtimi mbi temën
- Mbledhja e të dhënave
- Analiza e të dhënave
- Prezantimi i të dhënave
- Diskutim dhe Reflektim

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

- Njohja me temën, qëllimin dhe pritshmëritë e temës. Kuptimi i koncepteve bazë që përmban tema. Orientohen për burimet e informacionit të kërkuar.
- Njihen me informacionin e sjellë për çdo skede. Diskutojnë rreth informacioneve të secilës pjesëtare të grupit. Vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Selektimi i informacionit që do të paraqitet në prezantim. Përcaktimi i formatit të prezantimit. Realizojnë paraqitjen në forma të ndryshme sipas përzgjedhjes që kanë vendosur grupet.
- Udhëzoni nxënësit në organizimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura dhe inkurajoni nxënësit të krijojnë paraqitje vizuale të të dhënave të tyre, për të komunikuar në mënyrë efektive gjetjet e tyre.
- Lehtësoni diskutimet në klasë ku nxënësit mund të ndajnë gjetjet e tyre, të përfshihen në analiza kritike dhe të vlerësojnë efektivitetin e qasjeve të ndryshme për trajtimin e çështjes së ndikimit të sportit në performancën sportive.
- Nxitini nxënësit të reflektojnë mbi të nxënit e tyre, të marrin në konsideratë perspektiva alternative dhe të propozojnë strategji ose veprime shtesë.

Përshkrimi i produktit të projektit: Inkurajoni nxënësit të zhvillojnë dhe zbatojnë një plan veprimi në lidhje me ndikimin e aktivitetit fizik e sportit në ndryshimet e organizmit të njeriut. Efekti i ndryshimeve në organizëm mbi performancën shkollore si dhe sporti dhe socializmi në shkollë.. Kjo mund të përfshijë rritjen e ndërgjegjësimit, organizimin e fushatave, vullnetarizmin ose evokimin për ndryshim. Nxënësit dokumentojnë veprimet e tyre dhe reflektojnë mbi ndikimin që kanë bërë në trajtimin e çështjes sociale.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer për planin e biznesit të zgjedhur.
- ***Analiza dhe interpretimi i të dhënave:*** Saktësia dhe përshtatshmëria e teknikave të përdorura për të analizuar të dhënat e mbledhura.
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e analizës, vlerësimi i zgjidhjeve të mundshme dhe reflektimi mbi veprimet personale të ndërmarra.
- ***Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit,*** individualisht dhe në progresin e grupit.

Model 4 i një projekti kurrikular për nxënësit në AML

Tema e projektit: Të jesh “Fit”

Nëntemat:

- Ç’është fitnesi dhe përbërësit e tij
- Rëndësia e të qenurit fit
- Fitnesi fizik, mendor dhe emocional
- Hartimi i një plani individual pune në funksion të përmirësimit të gjendjes fizike

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:

Projekti do të zgjasë gjatë tre periudhave të realizuara në gjashtë orë mësimore në lëndën e edukimit fizik, sporte dhe shëndet , të planifikuara dy orë për çdo periudhë.

Klasat pjesëmarrëse: Klasa XI

Rezultatet e të nxënit:

Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi demonstroi aftësitë kërkimore, përgatitjen e pyetësorëve dhe intervistave, të përpunimit dhe analizës së të dhënave, për të kuptuar rëndësinë e tyre dhe për të propozuar zgjidhje të mundshme.

- Demonstron njohuritë e marra për grumbullimin e të dhënave;
- Të dallojnë informacionin e marrë nga interneti , nga literatura e rrjete sociale .
- Të rendisin logjikisht sipas çështjeve të dhëna materialet e gjetura .
- Të strukturojnë përmbajtjen .
- Realizon postera ose fletëpalosje me një mesazh të caktuar ;
- Bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht në progresin e grupit.
- Prezanton informacionin e grumbulluar dhe argumenton atë.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit


- Ç’është fitnesi dhe përbërësit e tij

- Efektet pozitive e të ushtruarit me veprimtari fizike në shëndet
- Fitnesi fizik, mendor dhe emocional
 - Pyetja kërkimore, qëllimi i studimit;
 - Pyetësi, intervista;
 - Grumbullimi i të dhënave;
 - Përpunimi i të dhënave;
 - Paraqitja, interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.
 - Hartimi i planit stërvitor, interpretimi, prezantimi.

Partnerët që do marrin pjesë në projekt : prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues, specialistë të sportit etj.

Veprimtaritë kryesore

- Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit;
- Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës së nxënësve në bashkëpunim me mësuesin;
- Zgjedhja nga nxënësit e detyrës hulumtuese për secilin grup;
- Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit;
- Hartimi i planit të veprimtarive për secilin grup;
- Kërkime njohurish të nevojshme në literaturën e rekomanduar, apo në internet në mënyrë që nxënësit të shfaqin aftësitë e tyre hulumtuese dhe studimore;
- Hartimi i pyetësorit (intervistave) dhe përzgjedhja e kampionit në të cilën do të kryhet pyetësi (intervistat);
- Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët, (intervistat), komunikimi me mësuesit, prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënësit sipas popullatës së përzgjedhur;
- Përpunimi i të dhënave;
- Ndërtimi i tabelave, skicave etj.;
- Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij;
- Hartimi i draftit përfundimtar të projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale;
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit.



Burimet kryesore të informacionit:

- Informacioni i marrë nga plotësimi i pyetësorëve (intervistave);
- Biseda me prindër, mësues;
- Materiale nga interneti
- Tekste të tjera që lidhen me situatën konkrete
- Revista, buletine të ndryshme
- Konsulta me specialistë të sportit

Përshkrimi i produktit të projektit:

Projekti do të përmbajë krijimin e planit të punës dhe fillimin e tij. Për të realizuar këtë

projekt nxënësit do të mbledhin informacione që lidhen me detyrën hulumtuese që ka secili

grup. Detyra hulumtuese ka të bëjë me studimin që lidhet me fitnesin dhe përbërësit e tij, fitnesin fizik, mendor dhe emocional. Duke analizuar rëndësinë e të qenurit fit nxënësit do të hartojnë një plan individual pune në funksion të përmirësimit të gjendjes fizike, në përshtatje me ndryshimet dhe nevojat që trupi paraqet në këtë moshë

Projekti do të shkruhet dhe prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:

- Tema e projektit.
- Rezultatet e të nxënës.
- Plani i veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës.
- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrim i shkurtër i projektit.
- Gjetjet e projektit. (Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme: mund të shkruhen në një poster, mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik etj.)
- Konkluzione të projektit.

Tematika e orëve të planifikuara:

- **Ora 1.** Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- **Ora 2.** Paraqitja e materialeve të grumbulluara nga grupet e punës. Diskutimi i planit të veprimtarive të projektit, hartimi dhe diskutimi i pyetësorëve (intervistave) . Konsulentët që mund të anketohen
- **Ora 3.** Diskutime e debate mbi materialet e grumbulluara në lidhje me temën. Përpunimi i materialit të grumbulluar, përpunimi i të dhënave të marra nga pyetësorët.
- **Ora 4.** Analiza e materialeve të projektit e përpunimi i tyre. Jepen këshilla apo sugjerime për përmirësimin e punës në rast se është e nevojshme. Ndërtimi i tabelave, diagrameve dhe diskutimi i planit stërvitor.
- **Ora 5.** Seleksionimi i materialeve që do të jenë më të qarta për zbatimin e këtij projekti. Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij
- **Ora 6.** Prezantimi përfundimtar i projektit , vlerësimi i tij dhe konkluzionet për secilin nxënës ose grup .

Ora e parë

Tema: Përzgjedhja e temës, ndarja në grupe.

Rezultatet e të nxënit:

1. Nxënësit përzgjedhin temën e ndajnë grupet
2. Rrahje mendimesh për caktimin e afatit kohor të projektit
3. Udhëzime për sigurimin e gjetjes së materialeve
4. Të ndahen nxënësit në 3-5 grupe pune.
5. Nxënësit të zgjedhin liderin e tyre sipas grupeve përkatëse.
6. Lideri të ndajë e të përcaktojë detyrat për secilin anëtar.

Metoda : Konsultime , rrahje mendimesh dhe udhëzime nga mësuesi .

Mjetet : Literaturë , kompjuter etj.

Organizimi i orës së mësimit

- Nxënësi në bashkëpunim me mësuesin zgjedh temën e projektit .
- Diskutime mes mësuesit dhe nxënësve për burimet e informacionit .
- Nxënësit ndahen në grupe sipas aftësive dhe dëshirës.
- Pas zgjedhjes së liderit të grupit ndahen detyrat për çdo anëtar.
- Shpjegimi nga mësuesi mbi qëllimin dhe rëndësinë e projektit.
- Caktimi i detyrave të orës së ardhshme
- Mësuesi në bashkëpunim me liderët e grupeve caktojnë afatet e kryerjes së detyrave.

Ora e dytë

Tema: Paraqitja e materialeve të grumbulluara nga grupet e punës.

Rezultatet e të nxënit:


- Nxënësi të paraqesë materialin e gjetur nga burimet e ndryshme.
- Të diskutojnë e të ndajnë mendimet e tyre për materialet.
- Të nxjerrin detyrat për vazhdimin e projektit.

Metoda: Diskutime, konsultime, ndarje mendimesh me secilin grup

Mjetet: Literaturë, internet etj.

Organizimi i orës së mësimit

- Nxënësit punojnë në grupet e tyre.
- Nëpërmjet teknikës “Rrjeti i diskutimit”, nxënësit diskutojnë situatat dhe të dhënat e siguruar nga burime të ndryshme.
- Nëpërmjet metodës “Mbajtja e strukturuar e shënimeve”, lideri i grupit mban shënime për të gjitha diskutimet dhe zgjidhjet e mundshme të situatave përkatëse. Më pas bën një përmbledhje të tyre i ndihmuar dhe nga shokët e grupit.
- Nxënësit përzgjedhin materialet që do të përdorin për projektin. Diskutimi i planit të veprimtarive të projektit, hartimi dhe diskutimi i pyetësorëve (intervistave) . Konsulentët që mund të anketohen
- Dhënia e mendimit të mësuesit rreth çështjeve të diskutuara për të orientuar nxënësit pasi të jenë dhënë mendimet e tyre .



Ora e tretë

Tema : Diskutime e debate mbi materialet e grumbulluara ne lidhje me temën .

Rezultatet e të nxënit:

- Të raportojnë për mbarëvajtjen e punës .
- Diskutime e debate për të qartësuar përshtatshmërinë e materialeve të gjetura me temën
- Prezanton materialet dhe argumenton idetë e tij në këtë projekt;
- Respekton punën e grupit

Metoda : Bashkëbisedim, vëzhgim i detajuar, diskutim .

Mjetet : Kompjuter, USB me punimet e grupeve

Organizimi i orës së mësimit

- Nxënësit paraqesin punën sipas grupeve të tyre.
- Nxënësit i përgjigjen pyetjeve të shokëve nga grupet e tjerë dhe komenteve të mësuesit.
- Grupet respektojnë kohën e përcaktuar për argumentim
- Diskutimi i materialeve të ndryshme filmike , skicave ose fotove për planin stërvitor.
- Përpunimi i materialit të grumbulluar, përpunimi i të dhënave të marra nga pyetësorët.

Ora e katërt :

Tema: Analiza e materialeve te projektit e përpunimi i tyre.

Rezultatet e të nxënit:

- Nxënësit të raportojnë për ecurinë e projektit e të analizojnë materialet e grumbulluara.
- Të përpunojnë në mënyrë individuale apo në grup materialet e grumbulluara pas diskutimeve mes tyre.
- Të jepen sugjerime për vazhdimin e projektit.

Metoda : Konsultime , rrahje mendimesh dhe udhëzime nga mësuesi .

Mjetet : Literaturë , kompjuter etj.



Organizimi i orës së mësimit

- Nxënësit rendisin materialet sipas nën temave të dhëna nga mësuesi
- Përmes diskutimeve me njeri-tjetrin në analizën e materialeve , ata ndihmojnë duke dhënë eksperiencën .
- Jepen këshilla apo sugjerime për përmirësimin e punës në rast se është e nevojshme. Ndërtimi i tabelave, diagrameve dhe diskutimi i planit stërvitor.
- Mësuesi jep udhëzimet mbi seleksionimin e materialeve të projektit .

Ora e pestë :

Tema: Seleksionimi i materialeve që do të jenë më të qarta për zbatimin e këtij projekti.

Rezultatet e të nxënit:

- Nxënësit të raportojnë për ecurinë e projektit në seleksionimin e materialeve të tyre.
- Të përpunojnë në mënyrë individuale apo në grup materialet e grumbulluara pas diskutimeve mes tyre.
- Të jepen sugjerime për përfundimin e projektit
- Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij

Metoda : Bashkëbisedim, vëzhgim i detajuar, diskutim .

Mjetet : Kompjuter, USB me punimet e grupeve

Organizimi i orës së mësimit

- Nxënësit rendisin materialet sipas nën temave të dhëna nga mësuesi
- Përmes diskutimeve me njëri-tjetrin në seleksionimin e materialeve , ata ndihmojnë duke dhënë eksperiencën .
- Mësuesi jep udhëzimet e fundit mbi strukturimin përfundimtar të projektit me shkrim , të paraqitjes me forma të ndryshme të punës e procedurën e vlerësimit të tij .

Ora e gjashtë :

Tema : Prezantimi përfundimtar i projektit , vlerësimi i tij dhe konkluzionet për secilin nxënës ose grup .

Rezultatet e të nxënit:

- Prezantimi përfundimtar i projektit nga secili nxënës apo grup pune duke e paraqitur në format A4 , në USB , ose në katalogje me pamje etj.
- Shpërndan fletëpalosje për ndërgjegjësimin, rëndësinë e fitnesit fizik, emocional dhe mendor në çdo moshë
- Vlerësimi i projektit ,konkluzionet për secilin grup

Metoda : Bashkëbisedim , vëzhgim i detajuar ,diskutim ,sintetizim .

Mjetet: Kompjuter , video projektor , USB me punime të secilit grup .

Organizimi i orës së mësimit

- Nxënësit paraqesin punët e tyre në monitor përmes një raporti përfundimtar ku paraqitet produkti përfundimtar (projekti) . Gjatë paraqitjes të gjithë mbajnë shënime për vërejtje apo sugjerime .
- Përzgjedhja e punëve më të mira .
- Nxënësit sipas punëve në grup apo individuale dorëzojnë portofolin e tyre mbi projektin
- Vlerësimi i nxënësve për punën e bërë (Vlerësohet puna në grup dhe puna individuale, prezantimi i projektit)

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- *Aftësitë kërkimore/hulumtuese:* Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer mbi Sportin dhe mirëqenien fizike në popullatë.
- *Niveli i analizës së situatës:* Qartësia e paraqitjes së informacionit për të vlerësuar përfitimet, pjesëmarrjen, dhe rezultate të tjera të matshme.
- *Aftësitë e prezantimit:* Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- *Mendimi kritik dhe reflektimi:* Thellësia e reflektimit mbi rëndësinë dhe sfidat e hasura gjatë projektit.
- **Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit,** individualisht dhe në progresin e grupit.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme. Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme. Nxënësit përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave,	0-2 pikë	3-5 pikë	6-8 pikë	9-10 pikë
	Nxënësit rrallëherë përdorin	Nxënësit ndonjëherë përdorin	Nxënësit zakonisht përdorin	Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit teknika të

fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	<i>teknika të përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i>	<i>teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i>	<i>teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i>	<i>përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i>
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin. Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6 -9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre. Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari. Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

